



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Udh. _____
Proj. strategjia _____
Nr. dërges _____
Nr. Prot. _____
Prot. No. _____
Dahim _____
Datë _____

DATE/A:	18.06.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1610/18
PËR/ZA/TO:	z. Shaban Tafa, Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim
CC:	z. Nenad STOJČETOVIĆ, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim
NGA/OD/FROM:	Shqip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Largimi i deponive të egra në Komunë dhe rekonstruktimi i mini parqeve në Vërbovc Komuna e Klllokotit "

I nderuari z. Tafa ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull " **Largimi i deponive të egra në Komunë dhe rekonstruktimi i mini parqeve në Vërbovc Komuna e Klllokotit** ", me nr. të prokurimit: 211-18-4007-521, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211-18-022-521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerreni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Largimi i deponive të egra në Komunë dhe rekonstruktimi i mini parqeve në Vërbovc Komuna e Klllokotit** ", me nr. të prokurimit: 211-18-4007-521, dhe me nr. të brendshëm: MKK-211-18-022-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04/L/042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 11.06.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1610/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "***Largimi i deponive të egra në Komunë dhe rekonstruktimi i mini parqeve në Vërbovc Komuna e Killokotit***", me nr. të prokurimit: *211-18-4007-521*, dhe me nr. të brendshëm: *MKK-211-18-022-521*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria për Komunitet dhe Kthim.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike të llojit punë, me vlerë të mesme në shumë prej 21.020,00 €.

Agjencia, gjatë analizimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka vërejtur se tek rubrika III.2.4. *Kapaciteti teknik dhe profesional tek dëshmia e kërkuar dokumentare* është kërkuar nga Operatorët ekonomik duhet të ofrojnë një listë të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit ku duhet të jenë të cekura, emri i Autoritetit Kontraktues, data dhe viti i realizimit të projektit – të bashkëngjiten referenca. Kërkesë kjo për të cilën Agjencia, gjithashtu konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht me nenin 69.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 69 Aftësitë Teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe nenin 26. Paragrafi 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi kontrata dhe referenca me të cilat do ta vërtetonte kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik. Mirëpo, nëse Autoriteti Kontraktues vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, duhet të ceket *referenca apo certifikata të Autoriteteve Publike dhe Personave Privat*, e jo siç ka vepruar në rastin konkret ku është cekur referenca vetëm nga Autoritetet Kontraktuese.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë punë të tilla të ngjashme.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Aftësia teknike/profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

